

Udhërrëfytyesi për në BE: Forcimi i të drejtës procedurale në Shqipëri

Në bashkëpunim me:



Fair

Trials

Rreth Fair Trials

Fair Trials është një vëzhgues global i drejtësisë penale me zyra në Londër, Bruksel dhe Uashington, D.C., që fokusohet në përmirësimin e së drejtës për një gjykim të drejtë në përputhje me standardet ndërkombëtare

Puna e Fair Trials mbështetet mbi besimin se gjykimet e drejta janë një nga gurët e themelit të një shoqërie të drejtë: ato parandalojnë shkatërrimin e jetëve nga dështimet e drejtësisë dhe i bëjnë shoqëritë më të sigurta duke kontribuar në sisteme transparente dhe të besueshme të drejtësisë që kanë fituar besimin e publikut. Edhe pse në parim njihet botërisht, e drejta themelore e njeriut për një gjykim të drejtë në praktikë po keqpërdoret.

Puna e Fair Trials ndërthur: (a) ndihmën e të dyshuarve për të kuptuar dhe ushtruar të drejtat e tyre; (b) ndërtimin e një rrjeti aktiv dhe të informuar të mbrojtësve të gjyimit të drejtë (ku përfshihen OJQ-të, avokatët dhe akademikët); dhe (c) luftimin e shkaqeve kryesore të gjykimeve të padrejta nëpërmjet kërkimeve, proceseve gjyqësore, advokimit politik dhe fushatave.

Në Evropë, ne koordinojmë Panelin Këshillimor të Ekspertëve Ligjorë - rrjeti kryesor i drejtësisë penale në Evropë, i përbërë nga mbi 200 firma ligjore të mbrojtjes penale, institucione akademike dhe organizata të shoqërisë civile.

Më shumë informacion në lidhje me këtë rrjet dhe punën e tij për të drejtën e një gjykim të drejtë në Evropë mund të gjenden në: www.fairtrials.org

Kontakt

Bruno Min

Drejtor Ligjor (UK & International), Fair Trials
bruno.min@fairtrials.net

Laure Baudrihay-Gérard

Drejtor Ligjor (Evrope), Fair Trials
laure.baudrihay@fairtrials.net

Fair Trials dëshiron të falenderojë Kezia Robson (juriste pranë Freshfields Bruckhaus Deringer) për kontributin e saj në këtë botim.

Versionin më të detajuar të këtij raporti e gjeni në adresën:

www.fairtrials.org

Fair Trials, Dhjetor 2020



Përmbajtje

Hyrje **4**

Pasqyra e gjetjeve **7**

Përkthimi Simultan dhe me Shkrim **9**

E drejta e informimit **11**

Mbrojtja me avokat dhe ndihmë juridike **13**

Prezumimi i pafajsisë **15**

Masat mbrojtëse procedurale për
të mitur të dyshuar apo akuzuar **16**

Hyrje

Ky raport vlerëson se si ligjet, politikat dhe praktikat Shqiptare krahasohen me standartet e ligjeve të BE'së për të drejtat procedurale të individëve të dyshuar dhe akuzuar në procedim penal. Raporti identifikon ndryshimet kryesore mes ligjeve Shqiptare dhe të BE'së që duhen zgjidhur nëpërmjet ndryshimeve në legjislacion, si dhe përcakton pengesat kryesore në zbatimin e tyre. Bazuar në këtë hulumtim, raporti jep gjithashtu rekomandime praktike për reformat.¹

Antarësimi i Shqipërisë në BE

Prej 2014, Shqipëria është kandidat zyrtar për antarësim në Bashkimin Evropian dhe në Mars të 2020, BE hapi zyrtarisht negociatat për anëtarësim pasi vlerësoj përparimin e madh të vendit dhe “vendosmërinë e tij për të zbatuar më tej programin e reformave të BE'së” për tu bërë Vëndi më I ri Anëtar.²

Përgjatë procesit të anëtarësimit, ligjvënia, të drejtat themelore dhe drejtësia janë cilësuar si sfida thelbësore për Shqipërinë. Kjo reflektohet dhe në pesë prioritetet kyçe që Komisioni ka përcaktuar si kusht për hapjen e negociatave, prioritetet janë të gjitha në zbatimin e drejtësisë, të drejtat e njeriut, dhe e drejta penale,³ të cilat janë në monitorim të vazhdueshëm.⁴

Përmirësimet e bëra në drejtim të këtyre prioritetëve ishin thelbësore për hapjen e negociatave, por raporti i Komisionit për zgjerim për Shqipërinë bën të qartë se mbetet shumë vend për përmirësim të mëtejshme, vecanërisht në drejtim të të drejtave themelore.⁵

Gjatë negociatave për integrim, nën vëzhgim të detajuar do të jetë Respektimi nga Shqipëria i standarteve ndërkombëtare dhe Evropiane në ligjvënie dhe të drejtat e njeriut. Sulmet kundër ligjvënies dhe të drejtave të njeriut në disa Vende Anëtare përbëjnë sfida serioze dhe në rritje vitet e fundit për BE'në.

¹Versioni i detajuar i raportit gjendet në linkun: https://ë.fairtrials.org/sites/default/files/Roadmap_to_the_EU_Membership_through_criminal_justice_reform_in_Albania.pdf

²Këshilli i Bashkimit Evropian, Procesi i Zgjerimit, Stabilizimit dhe Asociimit – Republika e Maqedonisë së Veriut dhe Republika e Shqipërisë – Përfundimet e Këshillit 7002/20, Bruksel, 25 Mars 2020

³Komisioni Evropian, Komunikimi i Komisionit drejtuar Parlamentit Evropian dhe Këshillit – Strategjia e Zgjerimit dhe Sfidat Kyçe 2013-2014 COM (2013) 700, Bruksel, 16 Tetor 2013, p.19

⁴Komisioni Evropian, Drafti i Stafit të Komisionit – Raporti për Shqipërinë 2020 aqë shoqëron Komunikimin e Komisionit për Parlamentin Evropian, Këshilli, Komiteti Evropian Ekonomik dhe Social dhe Komiteti i Rajoneve – 2020 Komunikimi për Politikën e Zgjerimit të BE-së, SWD (1010) 354, Brussels, 6 October 2020

⁵Ibid.

, gjithashtu ato shërbejnë për të na kujtuar qartazi se respektimi i vlerave thelbësore të BE'së nuk mund të jetë opsional. BE duhet të siguroj, si parakusht të pandryshueshëm për hyrje në BE, që vendet candidate janë të afta që jo vetëm të respektojnë këto vlera, por dhe ti zbatojnë të drejtat themelore në praktikë. Në rast të kundërt, vlerat e përbashkëta që janë themeli i BE-së dhe ruajnë njësinë e tij, do të viheshin në rrezik serioz.

E drejta Penale dhe Anëtarësimi në BE

Edhe pse e drejta penale është një prioritet kyc në procesin e anëtarësimit të Shqipërisë, fokusi kryesor i BE-së ka qënë në reformën në gjyqësor për të përmirësuar transparencën dhe pavarësinë e tij, si dhe për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar. Ndërkohë, respektimit të standarteve minimale të të drejtës së mbrojtjes i është kushtuar më pak vëmendje.

'Garancitë ligjore për gjykim të drejtë' mbeten, sidoqoftë, pjesë e qartë e 'acquis' të BE'së.⁶ Si të tilla, ato janë pjesë e ligjeve dhe rregulloreve të përbashkëta të të gjitha Vendeve Anëtare dhe duhen zbatuar nga vendet candidate për të hyrë në BE. Përvec standarteve të përcaktuara nga Statuti i BE'së për të Drejtat Themelore, këto rregulla të përbashkëta janë përmbledhur në gjashtë direktiva që u adoptuan si rrjedhojë e Strategjisë të BE të 2009 për të forcuar të drejtat procedurale të personave të dyshuar dhe të akuzuar në procedim penal. Gjashtë **'Direktivat e Strategjisë'** janë:

- Direktiva 2010/64/BE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit të 20 Tetorit 2010 mbi të drejtën për përkthim simultan dhe me shkrim në procedim penal (**'Direktiva e përkthimit dhe interpretimit'**)
- Direktiva 2012/13/BE Parlamentit Evropian dhe e Këshillit të 22 Maj 2012 mbi të drejtën për informim në procedim penal (**'Direktiva për të Drejtën e Informimit'**)

- Direktiva 2013/48/BE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit të 22 October 2013 mbi të drejtën e përfaqësimit nga një avokat në procedim penal dhe në rast urdhër arresti Evropian, si dhe mbi të drejtën për të njoftuar një palë të tretë pas heqjes së lirisë si dhe të komunikimit me persona të tretë dhe autoritetet konsullore ndërsa në heqje lirie. (**'Direktiva e mbrojtjes me avokat'**)
- Direktiva 2016/800 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit të 11 May 2016 mbi masat mbrojtëse për të mitur që janë të dyshuar apo akuzuar në procedim penal. (**'Direktiva për të miturit'**)
- Direktiva 2016/343 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit të 9 March 2016 mbi forcimin e disa aspekteve të prezumimit të pafajsisë dhe të së drejtës për të qënë i pranishëm në gjyq në procedim penal (**'Direktiva për Prezumimin e Pafajsisë'**)
- Direktiva 2016/1919 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit të 26 October 2016 mbi ndihmë juridike për persona të dyshuar dhe të akuzuar në procedim penal, dhe për persona të përfshirë në raste urdhër arresti Evropian. (**'Direktiva për Ndihmë Juridike'**)

Interesi i BE-së për respektimin nga Shqipëria e Direktivave të Strategjisë.

Zbatimi i efektshëm i Direktivave të Strategjisë është thelbësor për anëtarësimin e Shqipërisë në BE, jo vetëm sepse ato janë pjesë e acquis, por edhe se ato plotësojnë dhe mbështesin përpjekjet për arritjen e prioriteteve të lartëpërmendura të BE'së për procesin e anëtarësimit. Një sistem i drejtë i të drejtës penale që garanton respektimin e të drejtave themelore të të pandehurit, duhet të krijojë një mekanizëm të efektshëm për të luftuar krimin e organizuar dhe korrupsionin. Përmirësimet në transparencën dhe pavarësinë e gjyqësorit do të kenë impakt të limituar tek drejtësia e vendimeve të tij nese nuk shoqërohen me mbrojtjen e efektshme të të drejtave të njeriut gjatë procedurave ligjore.

⁶ Acquis i BE-së, Kapitulli 23 Gjyqësori dhe të Drejtat Themelore

Komisioni Evropian, Drafti i Stafit të Komisionit – Raporti për Shqipërinë 2020 që shoqëron Komunikimin e Komisionit për Parlamentin Evropian, Këshilli, Komiteti Evropian Ekonomik dhe Social dhe Komiteti i Rajoneve – 2020 Komunikimi për Politikën e Zgjerimit të BE-së, SWD (1010) 354, Brussels, 6 October 2020

Transpozimi i Direktivave të Strategjisë është kryesor për funksionimin e efektshëm të mekanizmave të bashkëpunimit në drejtësi të BE-së. Dy dekadat e fundit, Vendet Anëtare kanë bashkëpunuar ngushtë për çështjet ndërkufitare, kryesisht nëpërmjet mekanizmave të njohjes reciproke si Urdhri I Arrestit Evropian ('UAE').

Funksionimi i këtyre mekanizmave varet nga besimi reciprok ndërmjet autoriteteve ligjore të Vendeve Anëtare që secili do të respektojë të drejtat themelore të personave në fjalë. Suksesi i këtyre instrumentave sabotohet kur autoritetet ligjore nuk kanë besim të plotë në respektimin nga Vendet e tjera Anëtare të të drejtave themelore.⁷

Një objektiv kryesor i Direktivave të Strategjisë është të sigurojë themele të forta për besim reciprok ndërmjet sistemeve ligjore të Vendeve Anëtare si dhe të përforcojë bashkëpunimin e frytshëm ndërkufitar për çështje të të drejtës penale. Si rezultat, zbatimi i suksesshëm i këtyre direktivave do të bëjë që Shqipëria të jetë një partner i besueshëm në ekstradimet inter alia, shkëmbimin e provave, dhe zbatimin e vendimeve gjyqësore.

Rëndësia e Direktivave të Udhërrëfyesit i kalon kufijtë e BE'së dhe Vendeve Anëtare. Në total, Direktivat e Udhërrëfyesit rregullojnë, sqarojnë dhe ndërtojnë mbi standartet për të drejtën e gjyqit të drejtë të përcaktuara nga Gjykata Evropiane e Te Drejtave të Njeriut ('GJEDNJ') dhe organe të tjerë ndërkombëtarë dhe rajonal për të drejtat e njeriut. Shqipëria përballet me sfida të shumta në lidhje me të drejtën për gjykim të drejtë në procedim penal. Kjo vërtetohet nga gjetje të GJEDNJ'së për shkelje gjatë viteve të fundit të aspekteve të së drejtës për gjykim të drejtë, përfshirë, përfaqësimin nga avokati,⁸ prezumimi i pafajsisë,⁹ dhe të drejtën për të qënë i pranishëm në gjyq/të drejtën për rigjykim pasi janë gjykuar në mungesë.¹⁰ Respektimi më i madh i Direktivave të Udhërrëfyesit do të ndihmonte në zgjidhjen e këtyre sfidave.

Përveç se ndihmojnë anëtarësimin e Shqipërisë në BE, këto Direktiva mund të shërbejnë si kriter për të vlerësuar çfarë nevojitet për ti njesuar më gjërë ligjet e Shqipërisë me standartet ndërkombëtare dhe Evropiane të të drejtave të njeriut.

Zbatime Praktike

Këto vite, Shqipëria ka ndërmarrë përditësim të ligjeve për ti njesuar ato me standartet e Direktivave të Udhërrëfyesit. Për shëmbull, Kodi i Procedurës Penale¹¹ ka pësuar amendamente të shumëta, dhe për të njesuar standartet e vendit me ligjet e BE-së për të drejtën e të miturve në 2017 u adoptua një e Drejtë e re Penale për Kodin e të miturve ('Kodi i të miturve'). Këto janë arritje të mëdha dhe përbëjnë progres të mirëpritur në rrugën drejt mbrojtjes të të drejtave në Shqipëri.

Eksperienca e Vendeve Anëtare të BE'së tregon se zbatimi i Direktivave të Udhërrëfyesit është shumë më tepër se sa amendimi i legjislacionit vendas për ta njesuar atë me standartet Evropiane. Thjesht ekzistenca e ligjeve që mbrojnë të drejtën e gjykimit të drejtë nuk siguron që këto të drejta respektohen në praktike.

Zbatimi praktik i ligjeve të BE-së kërkon një qasje më të gjithësishtme që siguron jo vetëm që gjuha e ligjeve vendase reflekton standartet e BE'së por edhe mbështetjen me një trup më të gjerë masash që mundësojnë zbatimin e vërtetë dhe të efektshëm të këtyre ligjeve.

⁷ Cf. Gjykata e Drejtësisë e Bashkimit Evropian, Cështja C-216/18 PPU Ministri për Drejtësi dhe Barazi v LM dhe cështja C-405/15 Aranyosi dhe Căldăraru

⁸ Laska and Lika. k. Shqipëria, no. 12315/04 dhe 17605/04, vendim of 20 April 2010, Kaçiu and Kotorri k. Shqipëria, no. 33192/07 and 33194/07, vendim i 25 Qershor 2013

⁹ Mulosmani k. Shqipëria, no. 29864/03, vendim i 8 Tetor 2013, Haxhia k. Shqipëria, no. 29861/03, vendim i 8 Tetor 2013

¹⁰ Shkalla k. Shqipëria, no. 26866/05, gjykim i 10 Maj 2011, Izet Haxhia k. Shqipëria, no. 34783/06, vendim i 5 Nëntor 2013, Hysi k. Shqipëria, no. 72361/11, Vendim I 22 Maj 2018, Malo k. Shqipëria, no. 72359/11, vendim i 22 Maj 2018, Muca k. Shqipëria, no. 57456/11, vendim i 22 Maj 2018, Topi k. Shqipëria, no. 14816/08, vendim i 22 Maj 2018, Karemani k. Shqipëria, no. 48717/08, vendim i 25 Shtator 2018

¹¹ Ligji No. 35/2017 i 30 Mars 2017

Pasqyra e gjetjeve

Ndryshimet në legjislacionin Shqiptar në vitet e fundit kanë mundësuar njësimin e ligjeve vendase me standartet minimale të BE-së në Udhërrëfyesin e Direktivave, dhe rregullat e procedurës penale Shqiptare, me disa përjashtime, tani janë në përputhje me ligjet e BE-së. Procesi i anëtarësimit, dhe, në veçanti Udhërrëfyesi i Direktivave, duket të kenë impakt pozitiv mbi të drejtat për mbrojtje, si dhe ndihmojnë respektimin e standarteve ekzistuese të të drejtave të njeriut, vecanërisht atyre që përcakton Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut ('KEDNJ'). Reformat e thella që sollën ndryshimet në Kodin e Procedurës Penale në vitin 2017 kanë përmirësuar ndjeshëm masat procedurale që mbrojnë persona të dyshuar ose akuzuar, ndërsa prezantimi i Kodit të të miturve në të njëjtin vit rezultoj në përmirësim të dukshëm të mbrojtjes të të drejtave të të miturve në konflikt me ligjin.

Sidoqoftë, analiza nga afër e ligjeve, politikave dhe praktikave në Shqipëri ngre dyshime për ushtrimin në jetë të disa prej të drejtave pjesë e Udhërrëfyesit. Edhe pse ligjet vendase janë kryesisht të njësuara me dispozitat operative të Direktivave, ekzistojnë pengesa të dukshme praktike dhe ligjore për zbatim e tyre të efektshëm në disa fusha. Sfidat kryesore, tani, për Shqipërinë është të shkojë përtej ndryshimeve legjislative në zbatimin e gjuhës së Direktivave, dhe të mbështesë standartet e Udhërrëfyesit me struktura më të gjëra ligjore dhe praktike që mundësojnë ushtrimin e vërtetë dhe kuptimplotë të të drejtave të personave të dyshuar ose të akuzuar.

Këto sfida duhen zgjidhur me metoda dhe me përfshirjen e partnerëve të ndryshëm. Metodat varrojnë nga rishikimi i sistemit të ndihmës juridike për të siguruar dhënien lehtë të ndihmës juridike falas dhe duke bërë ndryshime specifike në procedurat e informimit të të dyshuarve, tek nisma më praktike, si p.sh. krijimi i një skeme funksionale të ndihmës juridike dhe shtimin e burimeve për institucionet e drejtësisë për të mitur.

Këto ndryshime duhen ndërmarrë nga autoritetet publike dhe ligjbërësit. Njësoj i rëndësishëm është dhe roli i shoqërisë civile dhe avokatëve mbrojtës për mbikqyrjen e trajtimit në praktikë të personave të dyshuar dhe akuzuar.

Është e rëndësishme që avokatët mbrojtës të trajnohen dhe angazhohen për zbatimin e Direktivave dhe të kërkojnë respektimin e standarteve përkatëse, si dhe të mbështesin shoqërinë civile në rolin e saj si mbikqyrëse e sistemit dhe promovuese e ndryshimeve.

Sfidat që has Shqipëria nuk janë unike. Fair Trials ka vënë re se shumë pengesa për zbatimin e efektshëm të Direktivave janë të njëjta me ato që hasen nga Vendet Anëtare ekzistuese të BE-së, si psh kontroll cilësie i paefektshëm në përkthim dhe interpretim, sisteme të papërshtatshme për dhënien e shpejtë të ndihmës juridike, dhe teprimi i kufizimeve fizike gjate gjykimit.¹²

Këto probleme nuk janë zgjidhur plotësisht në BE dhe fakti që Shqipëria ndan shume nga sfidat për respektimin e të drejtës për gjykim të paanshëm me Vendet Anëtare të BE-së do të thotë se ndarja e eksperiencave dhe dialogu i vazhdueshëm mes aktivistëve në juridiksione të ndryshme do të sillte të mira të shumta.

Duhet theksuar që, dhe pse objektivi parësor i Qeverisë Shqiptare në transpozimin e Direktivave duket të jetë suksesi në procesin e anëtarësimit në BE, e drejta e mbrojtjes nuk mund të konsiderohet thjesht një kusht formal për integrim. Direktivat e Udhërrëfyesit mbështesin fort përmirësimin e sistemit të drejtësisë penale, por nuk japin udhëzime të detajuara mbi të drejtën e gjykimit të paanshëm. Sfida të mëdha, si psh paraburgimi dhe diskriminimi në bazë rrace, që hasen shpesh në sistemet e të drejtës penale në të gjithë Evropën, nuk janë adresuar mjaftueshëm në ligjet përkatëse të BE-së. Përmirësimi në respektimin e të drejtave themelore dhe ligjëvenie nuk mund të arrihen vetëm nëpërmjet fokusit të ngushtë të Direktivave të Udhërrëfyesit – Këto sfida duhen përballuar me masa dhe objektiva të një spektri më të gjërë që synojnë forcimin e të drejtës për gjykim të paanshëm.

¹² Fair Trials, Ku e kam Avokatin? – Zbatimi i efektshëm i ndihmës juridike në paraburgim, 2019; Fair Trials, i pafajshëm deri sa të provohet e kundërta? – Prezantimi i të dyshuarëve në procedim penal, 2019; Agjencia e të Drejtave Themelore, Të drejtat në zbatim: qasja në avokat dhe të drejtat proceduriale në procedim penal dhe të urdhër arrestit Evropian, 2019

Interpretimi dh Përkthimi

Ligjet në Shqipëri duket se përputhen gjerësisht me Direktivat e Përkthimit dhe Interpretimit. Kushtetuta e Shqipërisë, plotësuar nga dispozitat e Kodit të Procedurës Penale, mbron të drejtën për ndihmë gjuhësore në gjykime penale, si për të dyshuar dhe të akuzuar të huaj që nuk flasin Shqip, ashtu dhe për ata me aftësi të kufizuara të fjalës dhe të dëgjuarit.

Sidoqoftë, ka tre sfida kryesore që duhen zgjidhur për të mundësuar futjen e efektshme në fuqi të standarteve të Direktivave:

1. Ka procedura dhe mekanizma të papërshtatshëm që nuk sigurojnë përkthim dhe interpretim të nivelit të lartë.
2. Shërbimet e përkthimit dhe interpretimit nuk janë plotësisht falas, as për ata që marrin ndihmë juridike.
3. Ka shumë paqartësi mbi cilat dokumenta përkthehen për persona të dyshuar apo të akuzuar.

Kontrolli i Cilësisë

Avokatë të shumtë mbrojtës kanë përcaktuar si problem të madh cilësinë e dobët të interpretuesve, dhe duket qartë mungesa e strukturave dhe mekanizmave që sigurojnë nivel mjaftueshëm të lartë përkthimi për të gjithë personat e dyshuar dhe të akuzuar. Në veçanti:

- Mungon ndryshim ligjor midis “përkthyesit” dhe “interpretuesit”, duke supozuar gabimisht që të dy profesionet kërkojnë të njëjtën përgatitje.
- Mungojë kritere që sigurojnë që përkthyesit dhe interpretuesit të kenë përgatitje përkatëse si interpretues ose përkthyes, ose të jenë të familjarizuar me gjuhën juridike.
- Mungojnë dispozita të qarta në Kodin e Procedurës që specifikojnë që përkthimi dhe interpretimi të jetë i nivelit mjaftueshëm të lartë që u mundëson personave të dyshuar dhe të akuzuar të marrin pjesë efektshëm në gjykimin e tyre.

- Mungon një trup rregullator që vendos dhe ruan standartin profesional të përkthyesve dhe interpretuesve.
- Mungon një mekanizëm transparent për përzgjedhjen e përkthyesve, që rrit shqetësimin për ekzistencën e klientelizmit, mungesën e pavarësisë, dhe cilësisë së ndihmës gjuhësore që u jepet personave të dyshuar dhe të akuzuar.

Kostoja e Interpretimit dhe Përkthimit

Kushtetuta dhe Kodi i Procedurës thonë se përkthimi duhet të sigurohet falas. Por, kostoja e përkthimit mbulohet nga shteti në vartësi të vendimit të procedims penale. Nëse i akuzuari dënohet, ai duhet të kthejë shtetit koston e përkthimit.

Kjo bie në kundërshtim të drejtpërdrejt me Nenin 4 të Direktivës së Përkthimit, i cili kërkon që shteti të mbulojë shpenzimet e përkthimit “*panvarësisht vendimit të gjykimit*”. Vecanërisht shqetësuese është fakti që kostoja e përkthimit duhet të kthehet nga i akuzuari dhe në rastin kur ai mbrohet me ndihmë juridike falas.

Kjo ka gjasa që të ndrydhë personat e dyshuar dhe të akuzuar për të kërkuar angazhimin e një përkthyesi edhe pse kjo është e drejta e tyre por edhe duke ditur që mungesa e përkthimit të saktë do të rrezikojë seriozisht paanëshmërinë e procedimit penal.

Përkthimi i dokumentave

Në ndryshim nga Neni 3 i Direktivës së Përkthimit, ligji Shqiptar nuk përcakton dokumentat që duhen përkthyer në një procedim penal. Në praktikë, pjesa më e madhe e dokumentave që konsiderohen “themelore” në bazë të Direktivës përkthehen, por mungesa e specifikimit të dokumentave në ligjin Shqiptar i jep pavarësi të tepërt autoritetit ekspert për përcaktimin e dokumentave që duhen përkthyer, gjë që vështirëson për personat e dyshuar dhe të akuzuar ankimin ndaj refuzimit për përkthim dokumenti.

Rekomandimet kyçe

- Ligji duhet të përcaktojë shprehimisht që përkthimi/interpretimi duhet të jetë i cilësisë së kënaqshme, përndryshe mosrespektimi i këtij standarti do të përbëjë bazë për kundërshtimin e provës, si dhe për të kërkuar zëvendësimin e përkthyesit.
- Përkthyesit/Interpretuesit e caktuar për procedime penale duhet të jenë ekspertë të specializuar si dhe tu kërkohej të marrin pjesë në trajnime mbi gjuhën juridike.
- Nevoitet një sistem rregullator më i shëndetshëm për përkthyesit /interpretuesit. Për të arritur këtë, autoritetet Shqiptare dhe aktorë të tjerë duhet të eksplorojnë mundësinë e krijimit të një trupi vet-rregullator për përkthyesit ekspertë.
- Me qëllim promovimin e përkthimeve më të sakta dhe te efektshme në procedime penale, ligjet dhe politikat Shqiptare duhet të qartësojnë dallimin mes interpretimit (me gojë) dhe përkthimit (me shkrim), si dhe përgatitjet dhe aftësitë e ndryshme që nevoiten për secilin.
- Në mënyrë që cdo person i dyshuar apo i akuzuar që nuk zotëron mjaftueshëm gjuhën Shqipe të mund të kërkojë interpretues pa risk financiar, përkthimi dhe interpretimi duhet të jetë falas panvarësisht rezultatit të gjykimit.
- Ligjet duhet të rishikohen duke përcaktuar dokumentat që minimalisht duhet të përkthehen.

E drejta e informimit

Ligji Shqiptar përputhet me shumicën e dispozitave kyçe të Direktivës për të dejtën e informacionit. Personat e dyshuar dhe të akuzuar gëzojnë të drejtën të informohen për të drejtat e tyre (përfshirë të drejtën e avokatit, të drejtën e ndihmës juridike falas dhe mjetet për ta ushtruar atë, të drejtën e informimit mbi akuzat kundër tyre si dhe të drejtën për të heshtur). Çdo personi të dyshuar dhe akuzuar duhet, sipas Ligjit, ti jepet Letra e të Drejtave. Në linjë me dispozitat e Direktivës për E drejta e informimit, Kodi i Procedurës Penale njeh të drejtën për qasje në dosjen e çështjes për të kundërshtuar arrestimin ose burgimin, dhe për të siguruar drejtësinë në procedime penale.

Informacioni për të drejtat dhe Letra e të Të Drejtave

Investigimi nga afër i dhënies së informacionit për të drejtat e tyre personave të dyshuar dhe akuzuar, në praktike, nxjerr në pah të meta të shumta që sabotojnë aftësinë e shumë të dyshuarve dhe akuzuarve për ti kuptuar ato, dhe për të marrë vendime të mirëinformuara në bazë të informacionit që u është dhënë.

1. Policia dihet të marrë në pyetje persona të dyshuar dhe akuzuar. si “dëshmitarë”, pa i vënë në dijeni për statusin e tyre ligjor dhe për të drejtat e tyre si persona të dyshuar dhe të akuzuar.
2. Letrat e të Drejtave nuk përmbajnë informacion të mjaftueshëm që u mundëson personave të dyshuar dhe të akuzuar të bëjnë zgjedhje të mirëinformuara në ceshtjet e tyre.
3. E njëjta Letër e të Drejtave përdoret për të gjitha kategoritë e personave të dyshuar dhe të akuzuar, panvarësisht moshës ose nëse janë në burgim apo në liri.
4. Letrat e të Drejtave përdorin gjuhë që nuk kuptohet nga një pjesë e madhe e personave të dyshuar dhe të akuzuar, dhe Policia nuk ka asnjë procedurë të efektshme për tu dhënë asistencë shtesë këtyre personave për të kuptuar të drejtat e tyre.

Njohja me dosjen e çështjes

Dhe pse ligji Shqiptar njih të drejtën e njohjes me dosjen e çështjes për të mbrojtur të drejtën e lirisë dhe të drejtën e mbrojtjes, në realitet ka disa sfida praktike që sabotojnë respektimin e kësaj të drejte. Për shembull:

1. Në praktikë, personave të burgosur apo të arrestuar u jepet qasje në dosjen e çështjes vetëm përpara seancës gjyqësore që rishikon ligjshmërinë e arrestit. Pasi asnjë informacion nuk jepet përpara seances, është shumë më e vështirë për individët të kundërshtojn arrestimin e tyre dhe ndalimin nga policia. Në rastet kur qasja në dosjen e çështjes jepet përpara seancave të dëgjimit, zakonisht avokatit i vihen në dispozicion vetëm pak minuta për të shfletuar dosjen në sallën e gjyqit. Kjo bën të pamundur për avokatin mbrojtës mbledhjen e provave për të kundërshtuar argumentat për paraburgim, duke mos u dhënë kështu personave të akuzuar dhe të dyshuar qasje kuptimplotë në dosjen e çështjes që të mund të kundërshtojnë burgimin e tyre.
2. Ligji Shqiptar u mundëson prokurorëve të refuzojnë të japin informacione që janë “sekret shteti”. Por ky përkufizim interpretohet shumë gjërë dhe mundëson që prokurorët të refuzojnë dhënien e informacionit mbi mjetet dhe mënyrat për investigimin e krimeve. Kjo saboton aftësinë e të pandehurit të kundërshtojë praktika investigative joligjore, dhe mund ti privojë ata nga qasja në prova që janë kye për mbrojtjen e tyre.

Rekomandime kyçe

- Duhet të ketë kufizime më të qarta ndaj policisë kur merr në pyetje individë që janë të dyshuar de facto pa i informuar ata për statusin e tyre si të dyshuar. Duhet të ketë masa të ekeftshme (përfshirë përjashtimin e provës) nëse këto të drejta dhunohen.
- Letra e të Drejtave duhet të përshijë listë me të gjërë të të drejta të mbrojtjes për tu mundësuar personave të dyshuar dhe të akuzuar marrjen e vendimeve të mirëinformuara për ushtrimin e të drejtave të tyre.
- Letra e të Drejtave duhet përshtatur për kategori të ndryshe personash të dyshuar dhe akuzuar. Vecanërisht, duhet të ketë një Letër të të Drejtave të veçantë për persona të burgosur dhe për të mitur, si reflektim që ky grup ka të drejta të veçanta, si dhe nevoja të veçanta për komunikim të efektshëm.
- Letra e të Drejtave duhet përpiluar me ndihmën e ekspertëve ligjore dhe gjuhësorë, me gjuhë të thjeshtë të kuptueshme nga shumica e personave të dyshuar dhe të akuzuar.
- Ligji duhet të përcaktojë që personave të dyshuar dhe të akuzuar u jepet qasje herët në dosjen e çështjes që të kenë kohë mjaftueshëm për të kundërshtuar efektshëm arrestimin ose burgimin e tyre.
- Refuzimi apo dështimi për dhënie qasjeje në dosjen e çështjes duhet të jetë subjekt i rishikimit gjyqësor.

Mbrojtja me avokat dhe ndihmë juridike

Ligjet Shqiptare duket të përputhen gjerësisht me shumicën e dispozitave të Direktivës për mbrojtjen me Avokat dhe atë të Ndhimës Ligjore. Personat e dyshuar dhe të akuzuar gëzojnë të drejtën e qasjes në avokat që në hapat fillestare të procedimit penal, përfshirë dhe gjatë marrjes në pyetje nga policia. Ndhima juridike është e disponueshme në të gjitha etapat në momentin që personi i dyshuar dhe i akuzuar gëzon të drejtën e avokatit. Megjithatë, në praktikë, ka sfida të mëdha që sabotojnë ushtrimin e efektshëm të këtyre të drejtave, shqetësim serioz përbën fakti që personat e dyshuar dhe të akuzuar në pozita të dobëta përballen me pengesa serioze në përfitimin e ndihmës juridike.

E drejta pwr tu mbrojtur me avokat

Gjuha e Kodit të Procedurës penale, për të drejtën e mbrojtjes me avokat nuk ka mospërputhje të rëndësishme me standartet Evropiane. Me vendim të Këshillit të Lartë të Prokurorëve në vitin 2019 u ndërmorrën reforma me synim rritjen e transparencës dhe të paanshmërisë në emërimin e avokatëve, nëpërmjet krjimit të një sistemi me rotacion.¹³

Sidoqoftë, ekzistojnë pengesa të dukshme praktike në dhënien e ndihmës së efektshme juridike, përfshirë dhe mungesën e hapsirave në rajonet e policisë dhe zyrat e prokurorisë që ruajnë konfidencialitetin e komunikimit klient-avokat

Mbetet e qartë që praktikat në lidhje me heqjen dorë nga e drejta për ndihmë juridike janë shumë larg standarteve të Direktivës për Mbrojtje me avokat. Personat e dyshuar dhe të akuzuar heqin dorë nga të drejtat e tyre duke nënshkruar një procesverbal me opsione(tick-box), pa masa mbrojtëse që sigurojnë që heqja dorë është (vullnetare dhe e padyshimtë).¹⁴

¹³ Rregullorja e Këshillit të Lartë të Prokurorëve për Garancinë për Mbrojtje të Detyrueshme dhe Emërimin e Avokatit Mbrojtës nga Lista e Avokatëve të Ndhimës Juridike Dytësore në Procese Penale në bazë të Parimit të Rotacionit, 12 Nëntor 2019.

¹⁴ Direktiva për Mbrojtje me avokat, Neni 9(1)

Ndihma juridike

Ushtrimi i të drejtës për qasje në ndihmë juridike përballet me sfida madhore. Edhe pse ligji i shkruar dhe politikat nuk përmbajnë dispozita që bien ndesh me dispozitat e Direktivës për Ndihmë Juridike, është e qartë se qasja praktike në ndihmë juridike pengohet nga kompleksiteti dhe papërshtatshmëria e sistemit të ndihmës juridike. Gjithashtu, shqetësime janë ngritur për cilësinë e asistencës juridike që financohet nga ndihma juridike.

Në Shqipëri veprojnë dy skema të ndihmës juridike, në varësi inter alia të llojit të asistencës juridike që nevojitet dhe llojit të personit të dyshuar apo akuzuar. Të pandehurit me aftësi të kufizuara dhe personat e arrestuar, për shembull, në bazë të Kodit të Procedurës, gëzojnë të drejtën e ndihmës juridike nëpërmjet mbrojtjes të detyrueshme, ndërsa pjesa më e madhe e personave të dyshuar dhe akuzuar që nuk kanë mundësi të paguajnë vetë asistencën juridike përfitojnë ndihmë juridike në bazë të Ligjit no. 111/2017 Për ndihmën Juridike të Garantuar nga Shteti (Ligji për Ndihmën Juridike). Ndryshimi kryesor mes dy skemave të ndihmës juridike është që në bazë të Kodit të Procedurës kostoja e mbrojtjes të detyrueshme mund të kthehet në rast se ata dënohen, ndërsa kjo nuk aplikohet për ndihmen juridike të përfituar në bazë të Ligjit për Ndihmë Juridike të vitit 2017.

Ky sistem ndëshkon hapur të pandehurit me aftësi të kufizuara, dhe rrezikon ti vendosë ata në probleme më të mëdha financiare. Gjithashtu, fokusi i dy skemave të ndihmës juridike është i paqartë. Përgjatë ecures së procedimit penal, në faza të ndryshme të saj, personat e dyshuar dhe të akuzuar mund të përfitojnë ndihmë juridike nga të dy sistemet.

Rekomandime Kyçe

- Gjykatat, autoritetet e ndjekjes penale, si dhe policia duhet të mundësojnë hapsira të përshtatshme për konsultime konfidenciale mes klientit dhe avokatit, përfshirë dhe në rajone policie.
- Zbatimi i reformave për futjen e sistemit me rotacion për emërimin e avokatëve duhet të monitorohet. Duhet të krijohet një skeme e efektshme për avokatët vullnetar që siguron dhe garanton qasje të paanëshme në asistencë juridike përgjatë ecures së procedimit penal, vecanërisht në etapat e para të saj, për personat e dyshuar dhe të akuzuar
- Nevoiten masa më të forta mbrojtëse që sigurojnë që heqjet dorë nga e drejta e qasjes në avokat të bëhen pa dyshime, me dijeni dhe me logjike.
- Në rast dënimi, personat e dyshuar dhe të akuzuar pa mundësi të mbulojnë koston e shërbimeve juridike, nuk duhet tu kërkohet të kthejnë koston e ndihmës juridike.
- Dy skemat ligjore aktualisht në fuqi duhet të thjeshtësohen dhe të bëhen më të qarta dhe më të sigurta për persona të dyshuar dhe të akuzuar që nuk mund të përballojnë koston e ndihmës juridike private, si dhe të sigurojnë që të pandehurit me aftësi të kufizuara nuk diskriminohen.

Prezumimi i pafajsisë

ushtetuta Shqiptare dhe Kodi i Procedurës mbrojnë parimet e përgjithëshme të prezumimit të pafajësisë, si dhe të drejtën për të qëndruar në heshtje. Sidoqoftë, dispozitat për “aspekte të veçanta” të prezumimit të pafajësisë të Direktivës për Prezumimin e Pafajësisë, përfshirë ndalimin e deklaratave publike për praninë e fajit si dhe përdorimin e kufizimit fizik, janë transpozuar në mënyrë të papërshtatshme dhe/ose janë zbatuar keq.

Prononcime publike për fajësinë

Nuk ka kufizime të veçanta që ndalojnë autoritetet publike, përveç policisë së shtetit, të bëjnë prononcime publike për fajësinë. Ka rregulla që limitojnë prononcimet që Gjykatësit dhe prokurorët mund të bëjnë për procedim penal, por në rast shkelje kundër tyre aplikohen vetëm masa disiplinore.

Konsultimet për këtë studim me avokatë dhe organizata të shoqërisë civile, tregojnë se prononcime publike për fajësinë bëhen rregullisht nga zyrtarë publik, përfshirë Kryeministrin, ministrat dhe anëtarë të parlamentit.

Ka rregullore për median që mundëson respektimin nga kjo e fundit të prezumimit të pafajësisë por të cilat nuk janë të efektshme, dhe shume shpesh ka shkelje të këtyre standarteve.

Përdorimi i kufizimeve fizike

Kodi i Procedurës Penale përcakton që kufizimet fizike, si psh prangat dhe kafazet përdoren vetëm në raste me rrezik për arratisje ose dhunë, por në praktike ato përdoren në shumicën e procedurave gjyqësore, panvarësisht nivelit të rrezikut ose rëndesës së akuzave.

Rekomandime Kyçe

- Duhet të ketë kufizime të qarta ligjore për pronocimet publike për fajësinë të bëra nga autoritetet publike, përfshirë gjykatësit, prokurorët, ministrat, kryeministrin, anëtarë të parlamentit, dhe nënpunësit civil.
- Duhet të ketë kufizime ligjore për deklaratat e bëra nga autoritetet publike (gjykatësit, prokurorët, ministrat, kryeministrin, anëtarë të parlamentit, dhe nënpunësit civil) në media për procedimet penale në mënyrë që këto deklarata të mos çenojnë prezumimin e pafajësisë.
- Trupat rregullator të Medias duhet të fuqizohen për të monitoruar dhe investiguar më gjallërisht shkeljet e prezumimit të pafajësisë.
- Gazetarët duhen edukuar mbi të drejtat e njeriut dhe etikën e lajmit për krime dhe procedura gjyqësore.
- Duhet të ketë standarte më të forta si dhe udhëzime më të qarta mbi përdorimin e kufizimeve fizike, që ato të përdoren vetëm për arsye sigurie.

Masa mbrojtëse procedurale për të mitur të dyshuar dhe të akuzuar

Kodi për të mitur, i cili hyri në fuqi në Janar 2018, bazohet gjërësisht mbi Direktivën për të Mitur, dhe reflekton standartet e Konventës së OKB-së mbi të drejtat e të miturve. Kodi përforcon të gjithat dispozitat mbi të miturit e dyshuar dhe akuzuar që përcaktohen nga instrumenta të tjerë ligjor, përfshirë Kodi Penal dhe Kodi i Procedurës Penale, dhe siguron një strukturë gjithëpërfshirëse ligjore për të miturit në konflikt me ligjin.

Kodi për të miturit, dhe masat praktike për zbatimin e dispozitave të tij, janë shëmbuj inkurajues të zbatimit të Direktivës për të miturit. Për shëmbull, Kodi i të miturve thotë se përveç heqjes së lirisë me vendosje në institucione të specializuara, duhet të ketë alternativa për rehabilitim që lejojnë kontakt të rregullt me anëtarë të familjes. Shume rajone policie kanë njësi të specializuara për drejtësinë për të mitur dhe dhoma të veçanta për marrjen në pyetje.

Kodi për të mitur është instrument i ri dhe për të vlerësuar më mirë efektshmërinë e tij nevojitet monitorim i mëtejshëm. Ndërsa shumë nga dispozitat e tij përputhen ose tejkalojnë standartete e Direktivës për të Mitur, eksperiencia tregon që në praktike këto standarte të larta nuk zbatohen të gjitha. Për shëmbull:

1. Në kundërshtim me ligjet vendase dhe standartet ndërkombëtare dhe Evropiane, kur të miturit janë në heqje lirie ata nuk mbahen të ndarë nga të rriturit.
2. Duhet të ndërtohen institucione për rehabilitimin e të miturve si alternative ndaj burgimit.
3. Policia nuk përdor mjaftueshëm hapsirat e veçanta për kryerjen e intervistave me të mitur.
4. Marrja në pyetje nga Policia nuk bëhet në mënyrë miqësore për të miturin, dhe mund të jenë padrejtësisht të gjata.
5. Në Rajonet e Policisë ka mungesa personeli të kualifikuar dhe staf mjeksor për dhënien e ndihmës përkatëse të miturve në konflikt me ligjin.

Ka shqetësime për efektshmërinë e ndihmës juridike dhënë të miturve. Mungon trajnimi i vazhdueshëm i avokatëve për drejtësinë për të mitur, dhe nuk ka garanci që avokatët e ndihmës juridike që emërohen për raste me të mitur janë të specializuar për punë me të mitur.

Rekomandime Kyçe



- Duhet të ketë udhëzime dhe standarte më të qarta për marrjen në pyetje të të miturve në konflikt me ligjin, me qëllim kufizimin e herëve që autoritetet mund ti marrin në pyetje të miturit.
- Në Rajonet e Policë dhe institucione të tjera duhet të ketë hapsira të veçanta për marrjen në pyetje të të miturve në konflikt me ligjin, dhe policia dhe prokurira të jetë e detyruar të përdorë këto hapsira, nëse janë të disponueshme.
- Në Rajonet e Policisë duhet të ketë më shumë psikologë, personel mjeksor si dhe personal shtesë ndihmës që të marrin pjesë gjatë marrjes në pyetje të të miturit dhe tu plotësojnë nevojat.
- Duhet të merren masa më të forta dhe të efektshme që sigurojnë që të miturit të mos burgosen me të rriturit.
- Institucionet Shtetërore duhet të krijojnë institucione të veçanta në përputhje me Kodin për të Mitur, për të siguruar heqje lirie alternative që synojnë rehabilitim sipas rastit të të miturit në ambiente të lira.
- Duhet të ketë mekanizma të efektshëm që sigurojnë që të miturit përfaqësohen nga avokatë të specializuar për të mitur të dyshuar apo të akuzuar. Si psh, nëpërmjet një regjistri të veçantë apo sistemi me rotacion.
- Të mundësohet trajnim për të gjithë ekspertët e të drejtës penale të përfshirë në procedura me të mitur. Trajnimi të jetë i detyrueshëm dhe buxhetimi i tij të mos jetë i varur nga komuniteti i donatorëve.

Fair
Trials



fairtrials.org



[@fairtrials](https://twitter.com/fairtrials)



[FairTrials](https://www.facebook.com/FairTrials)